



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**  
**Legjislacioni i II**  
Nr. \_\_\_\_\_,  
Prishtinë, më 25.09.2007

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Mbledhja është mbajtur më 25.09.2007, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, salla N-225, duke filluar në orën 11,00.

- Nga shërbimi i Sekretariatit të Kuvendit, në mbledhje morën pjesë: Natasha Prica – Tishma, Ahtere Loxha dhe Arta Hajra.
- Monitoruesit nga OSBE dhe NDI.

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Komisionit, Naser Osmani.

Pasi që konstatoi se ftesës për pjesëmarrje nuk i është përgjigjur Safete Hadergjonaj, nënkryetare e dytë e Komisionit, Demir Lima dhe rifat Krasniqi, anëtar, kryetari e hapi mbledhjen e Komisionit dhe propozoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të datës 30.08 dhe 4.09.2007,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave, me amendamentet e propozuara,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit si dhe i raportit të Komisionit funksional – Komisionit të Sigurisë me amendamentet e propozuara,
5. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit konstatoi se rendi i propozuar u miratua njëzëri dhe hap shqyrtimin për pikën e dytë të rendit të ditës.

## 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të datës 30.08 dhe 4.09.2007

Kryetari konstatoi se procesverbalet u miratuan pa vërejtje dhe hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës.

### 3. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave me amendamentet e propozuara,

**Kryetari** – Sot në rend të ditës është njëri nga ligjet me procedimin e të cilit jemi vonuar, për të cilin janë të interesuar ekspertët nga Uashingtoni me të cilët kemi realizuar dy shqyrtime publike, njërin me 13.06.2006 në Zyrën Amerikane, me përfaqësuesit e Qeverisë dhe me ekspertët vendor dhe ndërkombëtar, dhe tjetrën më 16.10.2006 me Zyrën Amerikane dhe Qendrën Informative Financiare të UNMIK-ut në bazë të nismës së Komisionit tonë. Janë mbajtur edhe mbledhje të tjera me ekspertët e USAID-it ku kemi marrë rekomandime të caktuara. Zyra Amerikane që të presim një kohë dhe ne kështu kemi vepruar, deri në momentin kur kemi pranuar që të angazhojmë një ekspert i cili do të punoj në këtë Ligj, z. Haki Demollin, profesor Universitar dhe drejtorin e Qendrës Juridike të Kosovës. Profesori i është përgjigjur kërkesës sonë që të na ofroj ndihmë dhe ka propozuar ndryshimin e rekomandimeve të caktuara të cilat do të na lehtësojnë punën në Komision dhe sipas nevojës të njëjtat do t'i sqaroj sipas kërkesës sonë më hollësisht. Fjala është për teknikat e reja të paraqitjes së amendamenteve si dhe në komentet e tij nuk janë shënuar se cilat nene duhet të zëvendësohen e cilat paragrafë mbesin, kjo nuk është problem nëse Komisioni nuk ka dilema për propozimet esenciale të ndryshimeve.

Ftoj profesorin Demolli që shkurtimisht të prezantoj vërejtjet e përgjithshme dhe komentimet që ka para Komisionit, ndërsa anëtarët e Komisionit që të paraqesin mendimet e tyre.

**Haki Demolli** – Kam propozuar një strukturë të re të Projektligjit, me që konsideroj se versioni i punës i ka 16 kapituj, që janë të shumtë. Projektligji duhet t'i ketë vetëm 5 kapituj si në vijim: Dispozitat e përgjithshme, Parandalimin e pastrimit të parave, Zbulimi i pastrimit të parave, masat ndëshkimore, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe dispozitat përfundimtare. Më konkretisht, jam orvatur që të bëjë kombinimin e zgjidhjeve të propozuara të tekstit punues të Projektligjit. Më së shumti jam përqendruar në kapitullin III, me titull: Zbulimi i pastrimit të parave, më saktësisht në Njësinë për zbulimin e pastrimit të parave. Kam propozuar 4 alternativa për formimin e njësisë nën autoritetin e: Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave dhe një numri prej X ministrash ose të një grupi të ministrave. Në titull të Njësisë, Komisioni le të vendos vet, se si do të emërtohet ky Institucion si Agjenci apo Njësi. Unë kam analizuar ligjet e njëjta apo të natyrës së ngjashme të vendeve të ndryshme në të cilat janë paraparë zgjidhje të ndryshme se kush bën themelimin e kësaj Njësie. Me Projektligj kjo njësi është në kuadër të Departamentit të Thesarit në MEF. Unë propozoj që Njësia për zbulimin e pastrimit të parave të jetë agjenci e pavarur të cilën e themelon Qeveria e Kosovës ose kryeministri. Përbërja dhe anëtarët e njësisë do të ishin si në vijim: Drejtori i Njësisë i cili propozohet nga ana e Ministrit të Punëve të Brendshme, sipas mundësisë duhet të jetë ekspert i njohur nga fusha për luftimin e kriminalitetit të organizuar, një prokuror i lartë i Kosovës të cilin e propozon Ministria e Drejtësisë, një anëtar i emëruar nga ana e MEF-it, një anëtar nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës dhe një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës të cilin e emëron kryeministri.

Njësia i paraqet raport për çdo 6 muajor Qeverisë së Kosovës, tri ministrive të theksuara dhe AQBK-së, si dhe raportin vjetor në fillim të çdo viti më së largu deri më 31 janar. Funkcionimi,

përgjegjësia, obligimet, përkufizimet e anëtarëve të njësisë, buxheti, procedura, raportimet, përjashtimet nga përgjegjësia, teknikat hetimore janë të parapara në komentimet e më pastajme të cilat anëtarët e Komisionit mund t'i shqyrtojnë dhe përkitazi me këtë mund të parashtrajnë pyetje, unë do të sqaroj çdo pyetje dhe propozim në mënyrë të veçantë. Më duhet të theksoj se me Projektligj në kapitullin e pestë emërtimit të Bashkëpunimit ndërkombëtar nuk i është dhënë hapësirë e mjaftueshme, përkundër faktit që Bashkëpunimi ndërkombëtar është i një rëndësie të veçantë për zbulimin dhe luftimin e pastrimit të parasë.

Mendime, sugjerime dhe pyetje të anëtarëve të Komisionit.

**Gani Koci** – në fillim kur e kishim para vetes shqyrtimin e këtij Projektligji, kemi pasur dilema lidhur me çështjen e vendit dhe të emërtimit të Njësisë e cila do të merrej me zbulimin e aktiviteteve kriminale për pastrimin e parasë. Si do që të thirrej Agjenci, apo Njësi, ajo do të merret me hulumtimin e pastrimit të parasë dhe sanksionet për vepra të tilla. Unë kam këto pyetje:

- Cilat do të ishin lidhjet e kësaj njësie me organet e policisë, kur policia e ka të njëjtën njësi e cila merret me hulumtimin dhe parandalimin e pastrimit të parave, kështu që këtu që këtu dyfishohen kompetencat. A do të jetë kjo Njësi – Njësi e re dhe e veçantë e cila do të eliminoj ekzistuesen, apo do të punojnë bashkërisht, me që deri më tani në kuadër të policisë ekziston Njësia për parandalimin e veprimeve kriminale, të kriminalitetit ekonomik dhe të pastrimit të parave e cila vepron në bazë të rregullores së UNMIK-ut me strukturë complete. A do të vazhdoj punën njësia ekzistuese për parandalimin e pastrimit të parasë në kuadër të MPB-së? Kjo nuk shihet nga komentimet e paraqitura. Pas miratimit të këtij Ligji do të dihej se kush do t'i emëroj këto struktura e kjo do të jetë MEF, që është krejtësisht në rregull.
- Duke pasur parasysh se nuk janë ofruar zgjidhje të mjaftueshme në këtë drejtim duhet ikur dyfishimit të mekanizmave për parandalimin e pastrimit të parasë, të asaj e cila tani më ekziston në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të njësisë e cila propozohet të formohet me këtë Projektligj. A do të vendoset bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy subjekteve, me qenë se bashkëpunimi duhet të ekzistoj edhe me policinë, por edhe me gjykatat.
- Ligji duhet të përcaktoj saktësisht normat e funksionimit të këtij mekanizmi dhe në mënyrë të qartë të definoj teknikat hetimore të cilat zbatohen përkitazi me pastrimin e parasë, me qëllim të sigurimit të provave për ndonjë vepër të dyshimtë. Diçka është risi në këtë Projektligj dhe do të duhej në mënyrë të qartë të rregullohen këto kompetenca dhe të mos dyfishohen disa dispozita. Ekziston një strukturë e tërë e agjencisë dhe ato janë: nëpunës, zyrtarë, inspektorë, dhe a kanë ata të drejtë që të paraburgosin njerëzit. Mendoj se ekzistojnë organe të tjera të cilat merren me këto çështje.

Konsideroj se as propozimi i parë dhe as i dyti nuk janë të sqaruar në mënyrë të konsiderueshme, kështu që ende kam dilema përkitazi me këto çështje.

- Është i pranueshëm fakti që ministri i ekonomisë dhe financave do të përcjell punën e agjencisë dhe të kryej mbikëqyrjen ndaj fenomenit të pastrimit të parasë. Këto janë edhe bankat edhe guvernatorët të cilët gjithashtu do të merren me këto çështje, mirëpo ligji na ofron një hapësirë të veprimit në këtë fushë.
- Cili do të jetë roli i hetuesve dhe kompetencat e tyre. A do të jenë këta shërbyes civil, apo ata do të kenë status të veçantë, që komentimet nuk e sqarojnë këtë.
- Agjencia e ka drejtorin e vetë i cili zbaton ligjin dhe rregulloren të cilën ai e miraton dhe duhet të përbëhet nga njerëzit eminent. A do të ketë kjo agjenci sektorë të posaçme për aktivitete të veçanta, apo oficer të cilët do të merren me çështje të caktuara.
- Ligji duhet të përcaktoj skemën e veprimit të këtij mekanizmi, me që dihet se prokurori publik nuk është njeri i thjeshtë i operativës, si dhe gjyqtari apo ministri si pjesë e këtij

- mekanizmi.
- Në mënyrë të qartë duhet të definohen se deri ku arrin përgjegjësia e agjencisë, të mos ndodh që ndonjëri nga hetuesit të shkoj në ndonjë vend të caktuar, dhe të paraqitet në mënyrë të rrejshme dhe ta paraburgosi ndokënd.

Përgjigjet në pyetjet e parashtruara, sugjerimet dhe mendimet.

**Haki Demolli** - Agjencia për parandalimin e pastrimit të parave themelohet si rezultat i rrezikshmërisë shoqërore të kësaj dukurie. Njësia për hulumtime dhe parandalimin e pastrimit të parave në kuadër të MPB-së do të vazhdoj punën dhe do të ketë për obligim që të bashkëpunoj me gjykatat dhe policinë dhe do të jetë në nivelin i cili do të rregullohet me Rregullore me sqarime të hollësishme. Gjithashtu do të jetë përgjegjëse për analizën dhe shqyrtimin e raporteve nga ana e subjekteve të parapara si dhe për marrjen e të gjitha informacioneve tjera.

Duke pasur parasysh se nuk kishte diskutues të tjerë, komisioni nxjerr këtë:

### **P e r f u n d i m**

- 1. Në parim pranohet versioni i vërejtjeve dhe komentimeve të përgjithshme lidhur me Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave,**
- 2. Miratohet struktura e propozuar e Projektligjit,**
- 3. Miratohet propozimi për emërtimin e organit për zbulimin e pastrimit të parave me emërtimin: “Agjencia për parandalimin e pastrimit të parave”,**
- 4. Miratohet propozimi që mjetet në shumë prej 15.000 € të paraqitura në doganë, të njoftohet banka për këto transaksione,**
- 5. Për çdo vit kalendarik agjencia e propozon buxhetin e vetë për vitin në vijim dhe ia dërgon për miratim MEF-it, ndërsa financimi i punëtorëve me orar të rregullt të punës sigurohet nga BKK,**
- 6. Për obligimet e organizatave joqeveritare dhe të partive politike (mbi lartësinë e pagesës së parave) do të shqyrtohen në ndërkohë në mbledhjen e ardhshme të Komisionit.**

Kryetari hapi për shqyrtim pikën e katërt të rendit të ditës:

- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit si dhe i raportit të Komisionit funksional – Komisionit të Sigurisë me amendamentet e propozuara,**

Pasi që nuk kishte vërejtje lidhur me projektligjin dhe raportin e komisionit funksional me amendamentet e rekomanduara, komisioni nxjerr këtë

### **Përfundim**

**Miratohen dispozitat e Projektligjit për dokumentet e udhëtimit me raportin e komisionit funksional – Komisioni për siguri me amendamente, me konstatimin se nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit që të njëjtin në procedurën e mëtutjeshme ta miratojë.**

Komisioni ka përfunduar punimet në ora 12,10.  
Shërbimi i komisioneve

KRYETARI I KOMISIONIT  
Naser Osmani

